




# Buletin informativ

## Rreth procesit të fiskalizimit

Qershor 2021



Nëpërmjet këtij buletini informativ, dëshirojmë t'ju risjellim në vëmendje se procesi i fiskalizimit po i afrohet afatit final të zbatimit për transaksionet pa para në dorë (ndërmjet shoqërive private). Në vijim të buletinëve informativ rreth këtij procesi, ekspertët fiskal të Mazars në Shqipëri kanë përgatitur një përmbledhje të çështjeve që duhen mbajtur në konsideratë nga tatimpaguesit në mënyrë që të veprojnë në përputhje me rregullat e reja, në fuqi nga 1 korriku 2021.

### ❖ Cilat janë afatet?

Duke filluar nga data 1 korrik 2021, të gjithë tatimpaguesit që kryejnë transaksione pa para në dorë, do të duhet të kryejnë procesin e faturimit, në përputhje me ligjin nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”. Për më shumë detaje rreth procesit, referohuni buletinëve informativ nr.2 – Shkurt 2020 dhe nr.10 – Dhjetor 2020 të përgatitur nga Mazars në Shqipëri.

Për lehtësi, gjeni link-et për të aksesuar buletinët informativ nr.2 dhe nr.10:

- i. [www.mazars.al/content/download/981158/51289255/version/1/file/Buletini%20informativ\\_%20Versioni%20shqip.pdf](http://www.mazars.al/content/download/981158/51289255/version/1/file/Buletini%20informativ_%20Versioni%20shqip.pdf)
- ii. [www.mazars.al/content/download/1028638/53658864/version/1/file/Buletin%20informativ%20-%20Dhjetor%202020.pdf](http://www.mazars.al/content/download/1028638/53658864/version/1/file/Buletin%20informativ%20-%20Dhjetor%202020.pdf)

Siç ju kemi informuar dhe më herët, që nga 1 Janari 2021, janë fiskalizuar të gjitha subjektet që kryejnë transaksione pa para në dorë me institucionet publike. Ndërkohë, afati i fiskalizimit për transaksionet me para në dorë mbetet data 1 shtator 2021.



# Buletin informativ

## Rreth procesit të fiskalizimit

### ❖ Cilat janë subjektet e çertifikuara për të kryer procesin e fiskalizimit?

Lista e subjekteve të çertifikuara për të kryer procesin e fiskalizimit është zgjeruar me aprovimin e subjekteve të reja, të klasifikuara në:

- subjekte të çertifikuara për transaksionet me para në dorë;
- subjekte të çertifikuara për transaksionet pa para në dorë;
- subjektet të çertifikuara për transaksionet me fatura shoqëruese; dhe
- subjekte prodhues të zgjidhjes software-ike për regjistrimin e pagesave pa para në dorë.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) ka paraqitur një listë të këtyre subjekteve që mund të aksesohet nëpërmjet linkun në vijim:

[www.tatime.gov.al/c/424/494/lista-e-subjekteve-te-certifikuara](http://www.tatime.gov.al/c/424/494/lista-e-subjekteve-te-certifikuara)

### ❖ Kush mund të përdorë procedurën e thjeshtëzuar të fiskalizimit?

DPT ka vënë në dispozicion të tatimpaguesve platformën qendrore për lëshimin dhe fiskalizimin e faturave (Self Care). Kjo platformë, përdoret vetëm nga tatimpaguesit që përmbushin kushtet e mëposhtme (si për tatimpaguesit që lëshojnë fatura me para në dorë dhe ata që operojnë pa para në dorë):

1. Kanë përgjegjësi tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël;
2. Nuk kanë me shumë se një vendndodhje të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;
3. Kanë statusin ligjor “Person fizik” dhe kategorinë e punësimit “I vetëpunësuar i vetëm”.

Ndërkohë kusht specifik për tatimpaguesit që kryejnë transaksione me para në dorë është fakti se nuk duhet të jenë subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar.

***Burimi:*** Vendimi nr.220 datë 12.03.2020, “Për përcaktimin e kategorisë së tatimpaguesve dhe të kriterëve të përdorimit të procedurës së thjeshtëzuar të fiskalizimit”.

### ❖ Pyetjet më të shpeshta?

Në kuadër të qartësisht të problematikave rreth procesit të fiskalizimit, DPT në bashkëpunim dhe me ekspertët e fushës ka mbajtur sesione informuese dhe diskutime me tatimpaguesit.

Një përmbledhje të pyetjeve më të shpeshta që kanë lindur rreth këtij procesi e gjeni në linkun:

[www.tatime.gov.al/c/424/444/pyetje-pergjigje-mbi-fiskalizimin](http://www.tatime.gov.al/c/424/444/pyetje-pergjigje-mbi-fiskalizimin)

***Shënim:*** Mbetet për t'u theksuar që pavarësisht që procesi i fiskalizimit është shoqëruar me një sërë procedurash të reja në lidhje me mekanizmin e faturimit, rregullat në lidhje me periudhën e faturimit, pagesës dhe gjithçka tjetër të lidhur me procesin e faturimit nuk ndryshojnë, duke mbetur të njëjta si përpara implementimit të këtij procesi.



# Buletin informativ

## Rreth procesit të fiskalizimit

### KONTAKT

#### MAZARS ALBANIA & KOSOVO

Për më shumë detaje mbi çështjet e mësipërme ose çështje të tjera në fushën fiskale, ju lutemi kontaktoni:

#### Teit GJINI

Managing Partner  
teit.gjini@mazars.al

#### Erinda XHAFERRAJ

Head of Tax Advisory Services  
erinda.xhaferraj@mazars.al

#### Adresa

Rr. Emin Duraku, Pall. Binjaket, Nr.5,  
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2222 889  
E-mail: info@mazars.al